



## Reportazh

# PËRJETË DITËLINDJE ENVER HOXHA

**15 tetor 2008**

U mbush një vi pas marrjes së vendimit të Komitetit Qëndror për festimin e 100 vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës nga PKSH. Bashkë me agimin e kësaj dite, komunistë e patriotë nga Shqipëria e Kosova janë nisur drejt Tiranës, për të marrë pjesë në Konferencën Kombëtare organizuar nga PKSH.

Atmosfera e kësaj veprimtarie ndihet në rrugët e Tiranës të mbështjellë me një diell vjeshte e zhurmëri metropoli, tek shfaqen në vende të dukshme, si në kohën e pushtimit fashist, parulla me gërma të kuqe, "Enver Hoxha", "PKSH", "1908".

Kalimtarët nën peshën e hallave të jetës nxitojnë me një pamje indiferente, duke hedhur rrëshqanthi vështrime e herë-herë duke qëndruar pak për të lexuar parullat e shkruara. Shpejtoj hapin e i afrohem një grupi shokësh që kanë mbërritur më parë, kur shoh tek ngrenë njëri pas tjetrit grushtin lart e nderojnë duke shqiptuar fort: "Vdekje fashizmit" – "Liri popullit" e duke uruar njëri-tjetrin: "Nder e lavdi Enver Hoxhës".

Në sheshin para Muzeut Historik Kombëtar të mbushur me pjesëmarrës bien në sy një grup shokësh që dallon prej të tjerëve nga qeleshet e bardha mbi krye. Janë të ardhur nga Kosova.

Fillon hyrja në sallën e përgatitur për të kremtuar këtë jubile, ku do të zhvillojë punimet Konferenca Kombëtare kushtuar 100 vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës. Atmosfera festive e solemne e sallës të bën për vete që në fillim. Shokët e ngarkuar me organizimin e saj të drejtuar nga shoku **Gjon Bruçi** kanë bërë një punë të lavdërueshme. Në sfond të tribunës, në ballë të sallës, shfaqet madhështore një fotografi e Enver Hoxhës, në krah të të cilit qëndron Flamuri Kombëtar dhe ai i PKSH.

Ora 10.00. Fillojnë punimet e Konferencës Kombëtare kushtuar 100 vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës. Këndohet Himni Kombëtar. Në tribunë kanë zënë vend Kryetari i PKSH shoku **Hysni Milloshi**, Sekretar i Përgjithshëm shoku **Muharrem Xhafa**, përfaqësuesi nga Kosova shoku **Remzi Hasani**, përfaqësuesi i familjes së Enver Hoxhës, **Dritan Kolaneci**, historiani **Xhemil Frashëri**, si dhe shoku **Raul Marko** nga PK e Spanjës, shoku **Vim Kenis** nga PP e Belgjikës, shoku **Bruno Morand** nga grupi komunist i Francës, shoku **Osman Yildiz** nga Partia Komuniste Revolucionare e Turqisë, shoku **Mehmet Ozer** nga Partia e Punëtorëve të Turqisë, shoku **Benardo Jofili** nga Partia Komuniste e Brazilit.

Mes duartrokitjeve e ovacioneve të pjesëmarrësve "Enver Hoxha", "PKSH", Sekretari i Përgjithshëm i PKSH shoku Muharrem Xhafa pas fjalës së tij përshëndetëse ia jep fjalën Kryetarit të PKSH shokut Hysni Milloshi, i cili mbajti referatin "Përse i janë mirënjohës historia kombëtare dhe populli shqiptar Enver Hoxhës". Referati u ndoq me interesim të madh nga pjesëmarrësit e konferencës dhe shpesh u shoqërua me duartrokitje e ovacione. Përmes një analize të thellë



shkencore marksiste-leniniste të figurës dhe veprës së pavdekshme të Enver Hoxhës, edhe kësaj here Hysni Milloshi me forcën e tij të spikatur intelektual dhe talentin e rrallë të publicistit komunist, solli një kontribut marksist-leninist mbi rolin e këtij individi të madh në historinë moderne të Shqipërisë. Në pushimin e seancave referati u shpërnda i botuar në gazetën "Zëri i së Vërtetës".

Në seancat që pasuan përshëndeti shoku Remzi Hasani në emër të shqiptarëve të Kosovës që merrnin pjesë në Konferencë. Reciton një poezi për Enver Hoxhën gjimnazistja nga Gjirokastra, Matilda Poçi. Prof. Dr. Xhemil Frashëri, historian, mbajti nënreferatin "Enver Hoxha personalitet i përmasave ndërkombëtare". Pas tij u mbajtën kumtesa nga Ndue Preng Gjata e Kristaq Mosko. Kumtesa e shokut Gjon Bruçi dhe një tjetër për rininë nuk u lexuan për arsye kohe. Në Konferencë përshëndetën të gjitha delegacionet e partive komuniste.

### 16 tetor 2008

Qindra komunistë e patriotë nga Kosova nisen drejt varrezave të Sharrës për të bërë homazhe nderimi tek varri i Enver Hoxhës. Ora 11.00. Kryetari i PKSH shoku Hysni Milloshi, Sekretar i Përgjithshëm shoku Muharrem Xhafa të shoqëruar nga qindra komunistë bëjnë homazh tek varri i Enver Hoxhës. Dy shokë komunistë nga Shkodra vunë një kurorë me lule në emër të PKSH. Në këtë orë mbërrijnë dhe përfaqësuesit e partive komuniste të botës për të bërë homazhe. Vjen për të bërë homazhe dhe Nexhmije Hoxha, e cila ndër të tjera tha: "Shokë, vëllezër e miq të Enver Hoxhës! Jemi mbledhur këtu të bashkuar t'i kujtojmë Enverit 100 vjetorin e lindjes. Populli e uronte: "Të rrosh edhe 100 vjet, shoku Enver", por sot në 100 vjetorin e parë që arriti, gjithë ne, shokë e miq dhe gjithë shqiptarët dashamirës, i urojnë Enverit të rrojë në shekuj, të përkujtohet edhe në shumë e shumë qindrave për çka ai ka bërë për Shqipërinë e kombin shqiptar". Pas saj mbajtën fjalime prekëse profesor Xhemil Frashëri si dhe profesor doktor Muhamet Mehmeti nga Kosova.

Festimi i 100 vjetorit të lindjes së mendimtarit e revolucionarit të madh Enver Hoxha nga PKSH, tregon jo vetëm nderimin e vlerësimin më të madh për themeluesin e udhëheqësin e lavdishëm të PKSH, por mbi të gjitha betimin solemn për të vazhduar me besnikëri rrugën marksiste-leniniste të Enverit, në kushtet e reja historike, në të cilat ndodhet Shqipëria sot në sistemin ekonomiko-shoqëror të kapitalizmit, për të mposhtur me vetmohim çdo sfidë borgjezo-reaksionare, nën flamurin e pamposhtur të Enver Hoxhës, për një botë të re pa shtypje e shfrytëzim të njeriut prej njeriut, për fitoren e socializmit e komunizmit.

Në fund të aktivitetit PKSH shtroi një drekë festive për delegacionet e huaja, të pranishmit nga Kosova, si dhe shumë militantë të Partisë.

Qemal Cicollari